

## SYLLABUS I LËNDËS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	<b>Fakulteti i Edukimit</b>
Titulli i lëndës:	<b>Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm</b>
Niveli:	<b>Bachelor</b>
Statusi lëndës:	<b>Obligative</b>
Viti i studimeve:	<b>IV</b>
Numri i orëve në javë:	<b>2+1</b>
Vlera në kredi- ECTS:	<b>5</b>
Koha / lokacioni:	<b>E marte</b> <b>Gr. 1. 12:30-14:00/ Salla 303 Gr. 2. 14:00-15:30/ Salla 303</b>
Mësimëdhënësi i lëndës:	<b>Prof. asoc. Dr. Zeqir Veselaj</b>
Detajet kontaktuese:	<b>Tel. 038 229021 E mail: <a href="mailto:Zeqir.veselaj@uni-pr.edu">Zeqir.veselaj@uni-pr.edu</a></b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Zhvillimi i qëndrueshëm është korniza e politikbërjes globale sot, dhe pjesë integrale e kurrikulave nacionale në shumicën e vendeve të botës. Në Kosovë, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm është pjesë e Kurrikulës Kurrikulare si çështje ndërkurrikulare që nga viti 2016.</p> <p>Studenti-mësimdhënës me këtë kurs do të pajiset me njohuri shkencore mbi konceptet themelore mjedisore dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, raportin e njeriut me mjedisin jetësor dhe zhvillimin socio-ekonomik si dhe rolin e edukimit të gjeneratave të reja për zhvillimin e qëndrueshëm.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Me kursin studentët do të fitojnë njohuritë bazë bashkëkohore shkencore mbi: konceptet kryesore të qëndrueshmërisë mjedisore, përbërësit e mjedisit, historikun e zhvillimit njerëzor që ka sjellë deri te nevoja për zhvillimin e qëndrueshëm; forcat kryesore që kanë shtyrë njerëzimin të koncentrohet në zhvillimin e qëndrueshëm; definicionet, konceptet dhe parimet kryesore; dimensionin ekonomik, social dhe mjedisor dhe ndërveprimet ndërmjet tyre; sistemet e matjes dhe indiaktorët e qëndrueshmërisëpresionet në mjedis dhe sektorët zhvillimor me ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm.,</p> <p>Kursi gjithashtu do trajtoj çështjet kryesore të edukimit mbi zhvillimin e qëndrueshëm përfshirë: strategjitë dhe metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënies për qëndrueshmërinë; kornizat e politikave arsimore globale për qëndrueshmëri, strategjitë dhe sfidat për zbatimin e edukimit për zhvillim të qëndrueshëm; përmbajtjen dhe metodologjinë e zbatimit të edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm në Kornizën Kurrikulare të Kosovës</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas kompletimit të kursit studenti/ja do të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përkufizoi zhvillimin e qëndrueshëm dhe interpretoi konceptet kryesore mjedisore, parimet udhëheqëse dhe konceptet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.</li> <li>- të përcakttoi konceptet bazë të medimeve mjedisore, presioneve për zhvillimin e qëndrueshëm, sektorëve ekonomik me ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm dhe sfidat globale mjedisore</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të analizoj dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshirë kompleksitetin, ndërveprimin dhe ndërvarësinë e tyre.</li> <li>- të hulumtoi dhe zbatoi sistemet e matjes dhe treguesve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel individual, lokal, nacional dhe global.</li> <li>- të aplikoj strategji bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit për zhvillimin e qëndrueshëm sipas praktikave bashkëkohore dhe kërkesave të Kurrikulës së Kosovës.</li> </ul>
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>	
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b> <b>Ditë/javë</b> <b>Gjithsejt</b>
Ligjërata	2              13              26
Ushtrime teorike/laboratorike	1              15              15
Punë praktike	/              /              /
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1              2              2
Ushtrime në teren	8              1              8
Kollokfiime, seminare	2              2              4
Detyra të shtëpisë	2              3              6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë/shtëpi)	2              15              30
Përgaditja përfundimtare për provim	1              15              15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2              3              6
Portfolio e studentit	8              1              8
<b>Totali</b>	<b>120</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata bashkë-biseduese dhe detyra praktike në klasë. Prezantime audiovizuale për diskutim të rasteve studimore të ndërlidhjes së qëndrueshmërisë. Detyra individuale dhe punë grupore hulumtuese.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Vlerësim është formativ dhe përfshin disa faza të vlerësimit:</p> <p>Vlerësimi i parë intermedier-----10%</p> <p>Vlerësimi i dytë intermedier-----10%</p> <p>Ushtrimi-----10%</p> <p>Pjesëmarrja/vijueshmëria-----15%</p> <p>Angazhimi në klasë-----5%</p> <p>Detyra individuale/grupore-----5%</p> <p>Portfolio e studentit-----5%</p> <p>Testi final-----40%</p> <p>Total-----100%</p> <p style="text-align: right;"><b><u>Kriteri i vlerësimit: Pikët (%) Nota</u></b></p> <p style="text-align: right;">95 -100----- 10</p> <p style="text-align: right;">85 – 94----- 9</p> <p style="text-align: right;">75 – 84----- 8</p> <p style="text-align: right;">65 – 74----- 7</p> <p style="text-align: right;">55 – 64----- 6</p> <p style="text-align: right;">Deri 54-----5</p> <p><b>Sqarim:</b></p>

	<p><i>Vlerësimet intermediere-</i> Vlerësimi i parë intermedier mbahet pas 5 javëve të para të ligjëratave. Vlerësimi i dytë intermedier mbahet pas 10 javëve të ligjëratave.</p> <p><i>Pjesa praktike-</i> është pjesë e vlerësimit final (me pikë) dhe bëhet nga asistenti/ja.</p> <p><i>Detyra seminarike</i> në formë projekti dorëzohet për vlerësim nga mësimdhënësit e lëndës. Detyra do kërkoj punë individuale ose grupe për adresimin e çështjeve praktike dhe zgjidhjeve për qëndrueshmërinë në klasa dhe në jetën reale të studentit.</p> <p><i>Portfolio e studentit-</i> përfshin materialet e kursit në dosje: ligjëratat, prezantimet Power Point, fletoren e punës në ligjëratë, punët seminarike dhe çdo elemente tjetër të realizuar nga studenti gjatë realizimit të kursit.</p> <p><i>Pjesëmarrja dhe angazhimi në klasë-</i> studenti do të vlerësohet deri 20 pikë gjatë ligjëratave sipas pjesëmarrjes (15 pikë) dhe angazhimit dhe aktivitetit në klasë (5 pikë).</p> <p><i>Pikët nga pjesa formative e vlerësimit</i> (vlerësimet intermediere, projekti, portfolio)- vlejné vetëm brenda <i>tri (3) afateve</i> të rregullta të provimit.</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	Veselaj Z. (2023). Qëndrueshmëria mjedisore dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm. Universiteti i Prishtinës 278 f.
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Veselaj Z. (2022): Zhvillimi i qëndrueshëm dhe edukimi për qëndrueshmëri. SHB. OLYM, Prishtinë - Grup autorësh (2010): Paketa e Gjellbër, REC Zyra në Kosovë dhe MASHT</li> <li>- Sylaj Skënder (2020) Edukimi mjedisor për zhvillim të qëndrueshëm, SH.B. Libri shkollor, Prishtinë</li> <li>- McKeown R. (2002): Education for sustainable development Toolkit, University of Tennessee (<a href="http://www.esdtoolkit.org">http://www.esdtoolkit.org</a>)</li> <li>- Dollma M. (2013), “Ekologjia humane” SHB Marin Barleti, Tiranë</li> <li>- Ramadani I. (2011) “Mjedisi jetësor roli i njeriut, sfidat dhe perspektiva”, SHB Vatra, Prishtinë</li> </ul>
<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java 1</b>	<p><i>Hyrje në shkencën e qëndrueshmërisë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Toka si ekosistem dhe qëndrueshmëria e planetit.</li> <li>- Historiku i konceptit dhe forcat shtytëse drejt zhvillimit të qëndrueshëm</li> </ul>
<b>Java 2:</b>	<p><i>Konceptet themelore të qëndrueshmërisë mjedisore</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mjedisi- përkufizimet dhe konceptet kryesore</li> <li>- Ndotja e mjedisit, ndotësit, burimet, efektet dhe pasojat e ndotjes.</li> </ul>
<b>Java 3</b>	<p><i>Përbërësit e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm-</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ajri: atmosfera, ndotja e ajrit; pasojat e ndotjes dhe masat kundër ndotjes.</li> <li>- Uji: hidrosfera, ndotja e ujrave sipas burimeve, pasoja në shëndet dhe mjedis.</li> </ul>
<b>Java 4</b>	<p><i>Përbërësit e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Toka (dheu), kategoritë e tokave, degradimi dhe ndotja e tokave.</li> <li>- Biodiversiteti dhe organizimi i tij, funksionet, dobitë dhe rreziqet për biodiversitetin. Zonat e mbrojtura natyrore</li> </ul>

<b>Java 5</b>	<i>Presionet në zhvillimin e qëndrueshëm</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbeturinat- llojet dhe menaxhimi. Riciklimi dhe cikli i produkteve.</li> <li>- Kimikatet dhe kimizimi i jetës tonë. Llojet dhe rreziqet nga kimikatet</li> <li>- Zhurma- burimet e ndotjes nga zhurma dhe pasojat.</li> <li>- Urbanizmi dhe ndikimi në mjedis.</li> </ul>
<b>Java 6</b>	<b>Testi i parë intermedier</b>
<b>Java 7</b>	<i>Sektorët kryesor zhvillimor me ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm:</i> Industria, energjia, transporti, bujqësia, pylltaria dhe turizmi përfitimet dhe ndikimet në mjedis të sektorëve përkatës.
<b>Java 8</b>	<i>Sfidat globale mjedisore dhe kufijtë planetar</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Efekti serrë, ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike.</li> <li>- Hollimi i shtresës së ozonit.</li> <li>- Acidifikimi dhe shirat acidike.</li> <li>- Ndotja e oqeanit botëror.</li> <li>- Kufijtë planetar.</li> </ul>
<b>Java 9</b>	<i>Zhvillimi i qëndrueshëm- historiku, definicioni, konceptet dhe parimet</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Konceptet dhe parimet ekologjike të qëndrueshmërisë.</li> <li>- Raportet dhe ndërveprimet mes tri dimensioneve të qëndrueshmërisë: ekonomisë, shoqërisë dhe mjedisit.</li> </ul>
<b>Java 10</b>	<i>Matja dhe indikatorët e zhvillimit të qëndrueshëm</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sistemet e matjes dhe indikatorëve të qëndrueshmërisë.</li> <li>- Indikatorët individual të qëndrueshmërisë: Gjurma ekologjike, Gjurma e karbonit dhe Gjurma e ujit.</li> </ul>
<b>Java 11</b>	<b>Testi i dytë intermedier</b>
<b>Java 12</b>	<i>Edukimi mjedisor dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Edukimi mjedisor dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm</li> <li>- Definicionet dhe parimet themelore të edukimit për qëndrueshmëri.</li> </ul>
<b>Java 13</b>	<i>Të nxënit për zhvillimin e qëndrueshëm</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Strategji dhe teknika të të nxënit për zhvillim të qëndrueshëm.</li> <li>- Integrimi i qëndrueshmërisë në lëndët mësimore.</li> </ul>
<b>Java 14:</b>	<i>Strategjitë e të menduarit dhe vendimmarrja për qëndrueshmërinë.</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Strategjia Four Ways of Thinking 4WoT.</li> <li>- Vendim-marrja dhe sistemet e vendim-marrjes për qëndrueshmërinë.</li> </ul>
<b>Java 15:</b>	<i>Mësimdhënia për zhvillimin e qëndrueshëm</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kompetencat profesionale dhe njohuritë për mësimdhënien për qëndrueshmëri.</li> <li>- Zhvillimi i qëndrueshëm në Kurrikulën e Kosovës.</li> <li>- Instrumentet për edukimin për qëndrueshmëri: Paketa e Gjelbër Junior</li> </ul>

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime është i obliguar dhe kushtëzohet me hyrje në provim. Nëse humben 30% e ligjëratave pa ndonjë arsye të qëndrueshme, studenti e humb të drejtën e hyrjes në provim sipas dispozitave të Statutit të UP-së. Rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë në procesin mësimor, shkyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.